

VENDIM
Nr. 206, datë 16.12.2019

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 60, DATË 15.4.2019, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAZ SHA PËR VITIN 2020”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 13, pika 1, nenit 16, pika 2, nenit 17, pika “e” dhe nenit 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, nenit 15, “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.4.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaaz sh.a. për vitin 2020”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 60, datë 15.4.2019, vendosi “Miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaaz sh.a.’ prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh, deri më datë 31.12.2019.

Në kushte kur ALBGAZ sh.a:

- Nuk ka paraqitur ende aplikim për përcaktimin e tarifës së transmetimit për periudhën e ardhshme rregullatore në vijim të komunikimit me shkresën nr. 540 prot., datë 10.9.2019, në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të “Rregullores për Organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”,

- Aplikimi duhet të paraqitet në përputhje me “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit për Gazin Natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 178, datë 8.11.2017, si dhe “Rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 4.11.2019.

- Shoqëria Albgaaz sh.a. nuk ka paraqitur ende planin e zhvillimit të rrjetit për periudhën 2019–2028 të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili do të reflektonte ndryshimet në planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit në zbatim dhe të vendimit të bordi të ERE-s me nr. 14, datë 31.1.2019.

- Mungesa e vlerës së investimeve të parashikuara për t’u kryer për vitin 2020, si dhe ato të realizuara për vitin 2019, të cilat janë komponentë të rëndësishëm të kostos së kapitalit të kësaj shoqërie, nuk bëjnë të mundur llogaritjen e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2020.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria Albgaaz sh.a., në zbatim të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe Direktivave të Komunitetit të Energjisë meqenëse aksesit në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE-ja.

- Nga Pasqyrat Financiare të shoqërisë Albgaaz sh.a. vërejmë se shoqëria ka qenë në pamundësi të mbulimit të aktivitetit si rrjedhojë e rezultateve financiare negative, kryesisht nga mosrealizimi i sasisë së parashikuar për lëvrim në rrjet për vitin 2018–2019, si dhe rritja e shpenzimeve operative, mbi ato të pranuar në llogaritjen e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2018–2019.

- Në këto kushte, është e domosdoshme lënia në fuqi e vendimit nr. 60, datë 15.4.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaaz sh.a. prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh, deri më datë 31.12.2019”.

- Neni 17, germa e, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se ERE-ja mund të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rastet kur

operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE-ja vendos masat e përshtatshme kompensuese.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 60, datë 15.4.2019, të bordit të ERE-s, për vitin 2020 deri në miratimin e një tarife mbështetur në aplikimin e shoqërisë Albgaz sh.a.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të Albgaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, germa “e”, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi në 1.1.2020.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti